

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented  
by the Council of Europe

## Konferencë rajonale *online*

### “Mbrojtja e pronës: GjEDNj-ja dhe jurisprudenca kombëtare në Ballkanin Perëndimor”

9 dhjetor 2020

10.00 – 12.30 CET dhe 14.00 – 16.30 CET

#### Konteksti

Kjo konferencë *online* ka si **objektiv** të ofrojë një platformë diskutimi mes aktorëve të ndryshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor mbi sfidat në lidhje me gëzimin e të drejtës së pronës, mbrojtur me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse gama e problemeve me të cilat përballen juridiksione të ndryshme në rajon varion nga kthimi i pronës së shtetëzuar deri te moszbatimi i vendimeve gjyqësore për çështje që lidhen me marrjen e pensioneve, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar disa qasje të konsoliduara në jurisprudencën e saj sa i përket çfarë përfshin prona dhe çfarë zgjidhjesh duhet të ekzistojnë për sigurimin e saj.

Për shkak të kufizimeve kohore, diskutimi do të fokusohet në disa fusha, me mundësinë për të diskutuar edhe për çështje të tjera që lidhen me to në seancat e diskutimit. Folësit do të jenë juristë nga Regjistri i GjEDNj-së, ekspertë të njohur të fushës dhe profesionistë të fushës së të drejtës nga vendet e rajonit.

#### Pjesëmarrësit:

- përfaqësues të Gjykatave Kushtetuese, Gjykatave të Larta, Gjykatave të Apelit, Ministrive të Drejtësisë, institucioneve kombëtare të trajnimit, Agjentëve Qeveritarë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Dhomave të Avokatisë, shoqatave profesionale të gjyqtarëve nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia dhe Kosova\*

- përfaqësues të Sekretariatit të Këshillit të Evropës dhe Regjistrit të Gjykatës Evropiane të të drejtave të Njeriut.

Konferenca do të mbahet në gjuhën angleze dhe do të ketë përkthim simultan në gjuhën shqipe, maqedonase dhe boshnjake/kroate/malazeze/serbe.

---

\* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented  
by the Council of Europe

EUROPEAN UNION

CONSEIL DE L'EUROPE

## Programi

### 10.00 Fjalët e hapjes

*Z. Mikhail Lobov, Shefi i Departamentit për Bashkëpunim dhe Politikat e të Drejtave të Njeriut, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës, Këshilli i Evropës*

*Moderator: z. Sergey Dikman, Koordinator Programi, Departamenti për Zbatimin Kombëtar të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës*

### 10.10 – 11.10 Qasjet dhe jurisprudenca relevante e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të drejtën e mbrojtjes së pronës

*Moderator: z. Andrey Esin, avokat për të drejtat e njeriut, ish jurist i Regjistrimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*

*Diskutime (iniciuar nga):*

*Znj. Ana Vilfan-Vospernik, juriste, Drejtoria e Juriskonsultës, Regjistri i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*

*Z. Dragoljub Popović, Gjyqtar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i zgjedhur sa i përket Serbisë (2005-2015)*

### 11.10 –11.20 Pushim

### 11.20 – 12.30 Probleme specifike dhe sfidat e reja sa i përket së drejtës për ta gëzuar paqësisht pronën (pjesa 1)

*Moderator: z. Andrey Esin, avokat për të drejtat e njeriut, ish jurist i Regjistrimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*

*Diskutime (iniciuar nga):*

*Znj. Elsa Toska, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, Shqipëri*

*Znj. Dušanka Radović, Gjyqtare në Gjykatën e Lartë, Mali i Zi*

*Znj. Sevima Sali-Terzić, Këshilltare Ligjore, Gjykata Kushtetuese, Bosnje-Hercegovinë*

### 12.30 –14.30 Pushim



### **14.30 – 16.00 Probleme specifike dhe sfidat e reja sa i përket së drejtës për ta gëzuar paqësisht pronën (pjesa 2)**

*Moderator: Znj. Elena Jovanovska-Brezoska, koordinator programi, Departamenti për Zbatimin Kombëtar të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës*

*Diskutime (prezantuar nga):*

*Znj. Lubov Stoytcheva, Shefe Seksioni, Departamenti për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*

*Znj. Polina Roussinova-Kucera, Departamenti për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*

*Z. Jeremy McBride, avokat, Monckton Chambers (Mbretëria e Bashkuar)*

*Z. Darko Pavlovski, Zyrtar ligjorë pranë misionit të OSBE-së në Shkup, ish jurist pranë Regjistrimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*

### **15.40 Vërejtjet përmbyllëse dhe vlerësimi nga pjesëmarrësit**

*z. Sergey Dikman, Koordinator Programi, Departamenti për Zbatimin Kombëtar të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës*

*Ky aktivitet organizohet me mbështetjen financiare të Bashkimi Evropian dhe Këshillit të Evropës në kuadrin e Programit të Përbashkët "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022". Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të asnjërës palë.*